



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1001 / Prot.

Tiranë, më 28/04 /2022

VENDIM

Nr. 08, datë 28.04.2022

PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË ME DIPLOMË TË DYFISHTË, STUDIME TË DOKTORATËS NË “QËNDRUESHMËRIA DHE INOVACIONI PËR PROJEKTIN E MJEDISIT TË NDËRTUAR DHE SISTEMIT TË PRODUKTIT”, MIDIS DEPARTAMENTIT TË ARKITEKTURËS (DIDA) TË UNIVERSITA DEGLI STUDI DI FIRENZE (UNIFI) DHE DEPARTAMENTIT TË ARKITEKTURËS, DEPARTAMENTIT TË TEKNOLOGJISË SË ARKITEKTURËS DHE RESTAURIMIT DHE DEPARTAMENTIT TË URBANISTIKËS, TË FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS, TË UPT-SË

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, VKM Nr. 185, datë 25.03.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018", Udhëzimeve të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 dhe Nr. 7, datë 31.03.2021, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, kërkesën e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.04.2022,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë me diplomë të dyfishtë, studime të Doktoratës në "Qëndrueshmëria dhe Inovacioni për projektin e mjedisit të ndërtuar dhe sistemit të produktit", midis Departamentit të Arkitekturës (DIDA) të Universita degli Studi di Firenze (UNIFI) dhe Departamentit të Arkitekturës, Departamentit të Teknologjisë së Arkitekturës dhe Restaurimit dhe Departamentit të Urbanistikës, të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maligari

